



## Periodiku AMF

### Zhvillohet Konferenca e 17-të Vjetore e IAIS-it

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), tetor 2010)

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) mbylli Konferencën e 17-të Vjetore dhe Takimin e Përgjithshëm që u zhvillua në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe, në datat 24-29 tetor 2010.

Vijon në faqen 2

### Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - shtator 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - shtator 2010 arritën shifrën 6,242,890 mijë lekë, përkundrejt 6,169,406 mijë lekë të realizuara në janar - shtator 2009 ose 1.19% më shumë.

Vijon në faqen 3

### Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - shtator 2010

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar - shtator 2010 u dominua në masën 93.22% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 6.78% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Vijon në faqen 5

### Zhvillimet e tregut të pensioneve vullnetare private për periudhën janar - shtator 2010

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, por ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve.

Vijon në faqen 6

### Ngjarje dhe zhvillime të tjera

#### Zhvillohet mbledhja e Komitetit të Tregjeve të Emergjencës

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë në bashkëpunim me Bordin e Letrave me Vlerë të Turqisë, në kuadrin e takimeve periodike të strukturave të përhershme, zhvilluan në datat 13 dhe 14 tetor 2010, në Stamboll, mbledhjen e Komitetit të Tregjeve të Emergjencës.

Vijon në faqen 7

#### Zhvillohet programi i trajnimit mbi njohjen me produkte të reja financiare dhe kuadri rregullator që lidhet me to

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve

(IOSCO) zhvilloi gjatë periudhës 19-22 tetor 2010, në Madrid, një program trajnimit mbi njohjen me produkte të reja financiare dhe kuadri rregullator që lidhet me to.

Vijon në faqen 8

#### Zhvillohet mbledhja e 7-të vjetore mbi korporatat, letrat me vlerë dhe aspektet e ngjashme në bashkimet dhe blerjet

Qendra për studimin e bashkimeve dhe blerjeve zhvilloi në datat 7 - 8 tetor 2010, në New York, USA, mbledhjen e 7-të vjetore mbi korporatat, letrat me vlerë dhe aspektet e ngjashme në bashkimet dhe blerjet.

Vijon në faqen 9

#### Zhvillohet "Aktiviteti i investimeve në sigurime - Sfidat e reja të institucioneve mbikëqyrëse"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake (PFSA) në bashkëpunim me "Training Initiative for financial Supervision (TIFS)" zhvilluan në datat 20 - 22 tetor 2010, në Poloni, Varshavë, seminarin me temë "Aktiviteti i investimeve në sigurime - Sfidat e reja të institucioneve mbikëqyrëse".

Vijon në faqen 9

#### IOSCO propozon parimet e mbikëqyrjes rregullatore për likuiditetin e padukshëm

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) tetor 2010)

Komiteti Teknik i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) ka publikuar një raport konsultativ me titull "Çështjet e ngritura nga likuiditeti i padukshëm" (Issues Raised by Dark Liquidity), ku jepen parimet për të asistuar autoritetet e tregjeve të letrave me vlerë të trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me likuiditetin e padukshëm.

Vijon në faqen 10

#### Edukimi i konsumatorit

##### Administrimi dhe mbikëqyrja e risqeve në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) tetor 2010)

Vijon nga numri i kaluar...

##### III. Çfarë mekanizmash mund të përdoren për t'i mbajtur nën kontroll risqet në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara?

Në këtë material risqet kryesore të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara.

Vijon në faqen 11

## Në këtë numër:

Zhvillohet Mbledhja e Grupit të Punës së Sigurimeve dhe Nënkomitetit të Çështjeve Ndër-sektoriale të IAIS-it

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

7

Edukimi i konsumatorit

11

## Zhvillohet Konferenca e 17-të Vjetore e IAIS-it

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), tetor 2010)

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) mbylli Konferencën e 17-të Vjetore dhe Takimin e Përgjithshëm që u zhvillua në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe, në datat 24-29 tetor 2010. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si anëtar me të drejta të plota i kësaj organizate, u përfaqësua në këtë eveniment të rëndësishëm nga Zj. Ermela Guxholli, Nënkryetare, Zj. Miranda Ramaj, Anëtare Bordi, Zj. Anxhela Dervishi dhe Z. Rinald Guri.



Zyrtarë të lartë të AMF-së, pjesëmarrës në Konferencën e 17-të Vjetore të IAIS-it

Konferenca 17-të Vjetore e IAIS-it, në të cilën morën pjesë rreth 450 pjesëmarrës, është evenimenti më i rëndësishëm i vitit i kësaj organizate. Ajo mbledh të gjithë anëtarët dhe vëzhguesit e saj që përfaqësojnë rregullatorë dhe mbikëqyrës të sigurimeve nga 140 vende në të gjithë botën, profesionistë të fushës dhe pjesëmarrës të tregut të sigurimeve. Tema e këtij viti ishte: "Porta e besimit në industrinë e sigurimeve".

Konferenca dha mundësinë për mbikëqyrësit dhe profesionistët e sektorit të sigurimeve për të diskutuar kushtet mbizotëruese të tregut, prirjet e reja dhe zhvillimet rregullative në këtë mjedis sfidues financiar. "Natyra në zhvillim e sektorit të

sigurimit me kompanitë e sigurimeve gjithnjë e më shumë në zgjerim e operacionet e tyre në nivel global, kriza financiare e shoqëruar me sfidat rregullatore solli si rezultat nevojën për reforma rregullatore," tha Peter Braumüller, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të IAIS-it. "Unë jam i bindur se IAIS ka angazhimin e të gjithë anëtarëve të vet dhe planet e strategjike të nevojshme për t'ju adresuar këtyre sfidave".

Në ndryshimet ekonomike aktuale që lëvizin me shpejtësi lind nevoja e krijimit të besimit në këto tregje. Kriza globale financiare ka gjeneruar një varg të gjerë të çështjeve të ndryshme dhe të vështira brenda sektorit financiar në mbarë botën, duke dhënë shkak për reflektim, analizë dhe rivlerësim të shumë aspekteve të riskut, menaxhimit i kapitalit, modelet e biznesit, etj. Konferenca u ofroi mundësi mbikëqyrësve të sigurimeve dhe profesionistëve të fushës për të shkëmbyer ide e për të diskutuar kushtet mbizotëruese të tregut, zhvillimin dhe tendencat e industrisë së sigurimeve, si dhe zhvillimet rregullatore për të forcuar sistemin e mbikëqyrjes së tregjeve të sigurimeve.

Një numër i rëndësishëm hapash dhe vendimesh janë marrë gjatë mbledhjeve të Grupeve të Punës dhe Mbledhjes së Përgjithshme ku përfshihen:

- Miratimi i një Plani Strategjik të organizatës për vitet 2011-2015. Qëllimi i planit strategjik është që t'i sigurojë Organizatës burimet në vend për të adresuar sfidat e mbikëqyrësve të sigurimeve dhe në këtë mënyrë të forcojë mbikëqyrjen e përgjithshme të sigurimeve.

- Miratimi i një plani dy-vjeçar (udhërrëfyese) për të siguruar aktivitetet e planifikuara gjatë dy viteve të ardhshme në mënyrë që të realizohen synimet strategjike në nivele të larta me plane veprimi të përcaktuara brenda planit strategjik. Udhërrëfyese përfshin vlerësimin e rekomandimeve të Bordit të Stabilitetit Financiar për reformën financiare. Në mënyrë të veçantë, IAIS do të ndërmarrë kërkime të mëtejshme për të

zhvilluar një analizë më të gjerë të riskut sistemik në sektorin e sigurimeve dhe do të zhvillojë një metodologji të treguesve sasiore dhe cilësore për të vlerësuar rëndësinë e këtij risku sistemik në nivel global. Përveç kësaj, IAIS do të ofrojë udhëzime për të identifikuar institucionet financiare globale dhe vendase me rëndësi sistematike. Duke plotësuar aktivitetet që lidhen me stabilitetin e tregut financiar dhe të sigurimeve në veçanti, IAIS do të vazhdojë të rrisë vendosjen e standardeve IFRS dhe zbatimin e tyre. Qëllimi i përcaktimit dhe zbatimit të standardeve është që të zhvillojë parimet globale, të qëndrueshme dhe koherente mbikëqyrëse.

Një projekt i rëndësishëm është vendosja e standardeve dhe zhvillimi i një kornize të përbashkët rregullatore për Mbikëqyrjen e Grupeve Aktive në Nivel Ndërkombëtar. Iniciativat e zbatimit të standardeve përfshijnë ato edukuese dhe ato të zhvillimit të vetë vlerësimit dhe të futjes së mekanizmave për të forcuar bashkëpunimin mbikëqyrës.

- Miratimi i tetë dokumenteve të mbikëqyrjes përfaqëson hapin e parë në rishikimin e parimeve bazë të sigurimit (ICP) duke mbështetur standardet dhe materialin udhëzues. Qëllimi është që të krijohet një kornizë koherente e këtyre parimeve të rishikuara, të cilat të jenë gati për miratim në 2011. Ky grup i parë i materialeve të rishikuara përfshin: parimin ICP 4 të Licencimit; parimin ICP 5 mbi përshtatshmërinë e personave; parimin ICP 13 mbi risigurimin dhe format e tjera të transferimit të riskut; parimin ICP 15 të Investimeve; parimin ICP 16 të menaxhimit të riskut në kompanitë e sigurimit; parimin ICP 17 të mjaftueshmërisë së kapitalit; standardet e bashkëpunimit ndërkufitar mbi Menaxhimin e Krizave, etj.

- Nënshkrimi i dy autoriteteve të tjera mbikëqyrëse të sigurimeve të Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit me IAIS (MMoU), çoi në 13 numrin total të nënshkruesve. MMoU është një marrëveshje për bashkëpunim dhe

shkëmbim informacioni e vendosur nga anëtarët e IAIS-it, me qëllim vendosjen e standardeve minimale, të cilave duhet t'i përmbahen nënshkruesit për të forcuar mbikëqyrjen ndërkufitare të shoqërive të sigurimit.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura


### Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - shtator 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - shtator 2010 arritën shifrën 6,242,890 mijë lekë, përkundrejt 6,169,406 mijë lekë të realizuara në janar - shtator 2009 ose 1.19% më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 47.71% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 52.29% të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 10.30% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje 0.83% të sigurimeve të Jo-Jetës. 89.89% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 9.41% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës dhe 0.71 % nga veprimtaria risigurimi.


Gjatë periudhës janar - shtator 2010 u nënshkruan rreth 516,888 kontrata sigurimi, ose rreth 11.67% më pak se në janar - shtator të vitit 2009.



### Struktura e tregut të sigurimeve, janar-shtator 2010



### Volumi i primit të shkruar bruto, janar-shtator 2010 (Jeta dhe Jo-Jeta)



### Volumi i primit të shkruar bruto, janar-shtator (2009-2010)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2009	2010
<b>Janar - Shtator</b>		
A) Sigurim i Jetës	532,367	587,182
B) Sigurim i Jo-Jetës	5,565,595	5,611,616
a) Sigurimi i Detyrueshëm	3,336,432	3,264,483
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	2,229,163	2,347,132
c) Risigurimi	71,444	44,093
<b>TOTAL</b>	<b>6,169,406</b>	<b>6,242,890</b>

#### Sigurimet e detyrueshme

Gjatë janar - shtator 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 52.29% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar - shtator 2010, arritën 2,282,429 mijë lekë, ose 8.01% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2009.

Në janar - shtator 2010, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 644,322 mijë lekë, ose rreth 29.03% më pak se në janar - shtator 2009. Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar

- shtator 2010 arritën në 337,733 mijë lekë, apo 7.06% më shumë se në janar - shtator 2009.

#### Sigurimet vullnetare

Në janar - shtator 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 2,978,407 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), ose 5.13% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 2,391,225 mijë lekë (përfshi dhe primet nga

risigurimi), vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 33.46% të pasuara nga, sigurimi kasko me 18.87% dhe nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 17.81%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë, si dhe prime nga veprimtaria e risigurimit.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar - shtator 2010, arritën në 292,827 mijë lekë, 1.42 % më pak se në janar - shtator 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 76.97% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar - shtator 2010 arritën në rreth 587,182 mijë lekë, ose rreth 10.30 % më shumë se në janar - shtator 2009. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie.

### Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 31.53% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life



udhëhoqi tregun me 54.56% të primeve.

### Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - shtator 2010 kapi vlerën 1,155,067 mijë lekë, ose 28.27% më shumë se në janar - shtator 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,361,041 mijë lekë, apo 87.52% të totalit.

### Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - shtator 2010

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar - shtator 2010 u dominua në masën 93.22% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (*bono thesari*) dhe 6.78% nga instrumenta afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 98.92% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - shtator 2010, flasin për një dominim të transaksioneve “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” përkatësisht me 50.83% dhe 22.10%

kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 96.80% të të gjitha transaksioneve në këtë treg, në raport me personat juridikë.


### Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B **“Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar”** gjatë periudhës janar - shtator 2010 ka pasur një rritje prej 301.76 milionë lekë ose në masën 3.76%, krahasuar me vitin 2009, shoqëruar me një ulje në masën 4.58% të numrit të transaksioneve.

Transaksioni i llojit C **“Blerje nga individët para afatit të maturimit”** gjatë periudhës janar - shtator ka pasur një rritje prej 731.65 milionë lekë ose 43.71%, krahasuar me vitin 2009,

ndjekur nga një rritje në masën 73.05% të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me periudhën janar - shtator 2009, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth 1,033.41 milionë lekë.



### Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë 2009, 2010

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mijë lekë)		Ndryshimi (në %)
	2009	2010	'10/'09-1
<b>Letra me Vlerë të Qeverisë</b>			
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	8,027.53	8,329.29	3.76
Individë	6,682.78	6,412.29	(4.05)
Persona juridike	1,344.75	1,917.00	42.55
C Blerje nga individet para afatit të maturimit	1,673.70	2,405.35	43.71
Individë	771.31	1,204.19	56.12
Persona juridike	902.39	1,201.15	33.11

### Zhvillimet e tregut të pensioneve vullnetare private për periudhën janar - shtator 2010

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, parë ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për periudhën janar - shtator 2010,

shihet një rritje prej 47.81% e kontributeve dhe një rritje prej afër 14.46% e numrit të kontribuesve, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Më poshtë pasqyrohen disa të dhëna mbi tregun e pensioneve vullnetare private:

**Tregu i Pensioneve Private Vullnetare (kontribute)**

Shoqëria	Kontribute (në lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010		2009	2010
Periudha Janar - Shtator			` 10/` 09-1		
Raiffeisen PENSIONS	36,425,880	47,325,062	29.92	55.46	48.74
Capital	16,123,071	34,221,355	112.25	24.55	35.25
Sigma IPP	13,135,862	15,541,862	18.32	20.00	16.01
<b>Total</b>	<b>65,684,813</b>	<b>97,088,279</b>	<b>47.81</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

**Tregu i Pensioneve Private (kontribues)**

Shoqëria	Numri kontribuesve		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010		2009	2010
Periudha Janar - Shtator			` 10/` 09-1		
Raiffeisen PENSIONS	1,666	1,791	7.50	38.29	35.96
Capital	1,738	2,177	25.26	39.94	43.71
Sigma IPP	947	1,012	6.86	21.77	20.32
<b>Total</b>	<b>4,351</b>	<b>4,980</b>	<b>14.46</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

**Ngjarje dhe zhvillime të tjera**

**Zhvillohet mbledhja e Komitetit të Tregjeve të Emergjencës**

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë në bashkëpunim me Bordin e Letrave me Vlerë të Turqisë, në kuadrin e takimeve periodike të strukturave të përhershme, zhvilluan në datat 13 dhe 14 tetor 2010, në Stamboll, mbledhjen e Komitetit të Tregjeve të Emergjencës.

Në takim u aprovuan 2 raporte te rëndësishme, të cilat përmbanin rekomandime për rregullatorët që operojnë në tregjet e emergjencës, në lidhje me ndërhyrjet në treg dhe tregun e letrave me vlerë të mbështetura nga instrumenta borxhi.

Këto raporte prezantuan një pamje gjithëpërfshirëse dhe informative të ndikimit që pati kriza financiare mbi tregun e letrave me vlerë të mbështetura nga instrumenta borxhi, mbi aktivitetin e bursave dhe mënyrën se si reagojnë rregullatorët në këto raste. Në këto raporte u përfshinë mësimet e nxjerra nga ndërveprimet e rregullatorëve dhe u përcaktuan rekomandime për praktikën më të mirë që duhet të ndiqet në këto fusha, duke ndihmuar autoritetet e tregut të letrave me vlerë për të shmangur dobësitë e tregut dhe për t'i shërbyer zhvillimit afatgjatë të tregut të kapitalit.

Më 15 tetor, u zhvillua Konferenca, ku rregullatorët e tregjeve të emergjencës ndoqën temat e referuara nga lektorë të njohur të tregut të letrave me vlerë.

Temat kryesore ku u përqendruan referimet ishin:

- arkitektura e re financiare globale, si dhe masat e ndërmarra për krizën financiare: A janë rregullatorët e letrave me vlerë në tregjet e emergjencës të aftë për të menaxhuar riskun sistematik?;
- tregjet e obligacioneve të korporatave në tregjet e emergjencës: përcaktimi i skenarit për zhvillimin e mëtejshëm të tyre;
- zbatimin e IFRS-ve në tregjet e emergjencës, diskutimeve dhe eksperiencës;
- tregtimi algoritmik dhe me frekuencë të lartë, si dhe sfidat që pozon ky tregtim ndaj tregjeve dhe rregullatorëve.

Konferenca i shërbeu dialogut midis rregullatorëve dhe pjesëtarëve të tjerë të tregut, si dhe forcimit të lidhjeve midis rregullatorëve nga juridiksione të ndryshme. Pjesëmarrja e gjerë në punën e këtij Komiteti, do të hapë rrugën për një bashkëpunim të mëtejshëm midis rregullatorëve të tregjeve emergjente.

### **Zhvillohet programi i trajnimit mbi njohjen me produkte të reja financiare dhe kuadri rregullator që lidhet me to**

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve (IOSCO) zhvilloi gjatë periudhës 19-22 tetor 2010, në Madrid, një program trajnimi mbi njohjen me produkte të reja financiare dhe kuadri rregullator që lidhet me to.

Sekretari i Përgjithshëm i IOSCO-s, Z. Greg Tanzer, gjatë ditës së parë, bëri një prezantim të zhvillimeve dhe sfidave të reja në rregullimin e tregut të titujve. Ai u ndal veçanërisht në misionet që kishte IOSCO si organizatë ndërkombëtare rregullatore, zhvillimet e reja të tregut, planet e ardhshme të IOSCO-s, sfidat e ndryshme që hasin rregullatorët në tregje të ndryshme të titujve dhe në strategjitë e kësaj organizate për të ardhmen. Në vazhdim, pati dhe prezantime të tjera në lidhje me parimet e IOSCO-s për produktet e reja e zbatimin e tyre dhe gjithashtu në lidhje me sfidat dhe zbatimin e MMoU-së.



Programi i trajnimit mbi njohjen me produkte të reja financiare dhe kuadri rregullator që lidhet me to

Në ditët në vazhdim u diskutuan: perspektiva e krizës së fundit financiare, shkaku dhe reagimi i rregullatorëve ndaj kësaj krize, derivativët, struktura dhe mënyra e funksionimit, produktet e reja financiare dhe vlerësimi sa më mirë i tyre, si dhe rreziqet dhe sfidat me të cilat mund të

përballen shërbimet financiare botërore në të ardhmen.

Programi i trajnimit ishte projektuar si një forum për shkëmbimin e praktikave më të mira për zhvillimin dhe rregullimin e tregut të letrave me





vlërë, të prezantuara këto nëpërmjet prezantimeve dhe studimit të rasteve të ndryshme nga vende të ndryshme të botës, të cilët ndanë eksperiencën e tyre në fushën e tregtimit të titujve.

Në këtë trajnim morën pjesë 75 përfaqësues nga rreth 42 juridiksione të ndryshme, duke përfshirë vendet më të zhvilluara dhe përfaqësues të tjerë të tregjeve në zhvillim.

Në fund të programit u shpërndanë certifikata të pjesëmarrjes për të gjithë të pranishmit.

### **Zhvillohet mbledhja e 7-të vjetore mbi korporatat, letrat me vlerë dhe aspektet e ngjashme në bashkimet dhe blerjet**

Qendra për studimin e bashkimeve dhe blerjeve zhvilloi në datat 7 - 8 tetor 2010, në New York, USA, mbledhjen e 7-të vjetore mbi korporatat, letrat me vlerë dhe aspektet e ngjashme në bashkimet dhe blerjet.

Në këtë mbledhje u diskutuan informacionet e fundit për bashkimet dhe blerjet, nga bankierë, investues, gazetarë, anëtarë të qeverisë dhe anëtarë të gjyqësorit.

Diskutimet kryesore u bënë midis paneleve të ekspertëve, të cilët janë të angazhuar në negociata në lidhje me blerjen e kompanive publike dhe private. Ata u përqendruan në këndvështrim me ligjin, zhvillimet e fundit, si dhe parimet bazë të aspekteve të bashkimit dhe të blerjes së korporatave.

Ndër temat kryesore, përmendim:

- blerjet në industrinë e shërbimeve financiare;
- adoptimi historik i reformave të legjislacionit në shërbimet financiare;
- ballafaqimi me avokatët në lidhje me etikën në blerjet dhe bashkimet, si dhe në transaksionet e lidhura me to;
- blerjet e kompanive private;
- blerjet e kompanive publike;

- përfaqësimi i firmave në investimet bankare në blerjet dhe bashkimet, si dhe transaksionet e lidhura me to;
- falimentimi në bashkimet dhe blerjet e korporatave;
- çështjet ligjore në bashkimet dhe blerjet dhe transaksionet e lidhura me to.

### **Zhvillohet “Aktiviteti i investimeve në sigurime - Sfidat e reja të institucioneve mbikëqyrëse”**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake (PFSA) në bashkëpunim me “Training Initiative for financial Supervision (TIFS)” zhvilluan në datat 20 - 22 tetor 2010, në Poloni, Varshavë, seminarin me temë “Aktiviteti i investimeve në sigurime - Sfidat e reja të institucioneve mbikëqyrëse”.

Qëllimi i seminarit, ishte prezantimi i metodologjisë së miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake (PFSA) në lidhje me aktivitetin e investimeve në sigurime, si dhe për të krijuar një forum diskutimi duke ofruar mundësinë për mbikëqyrësit e vendeve evropiane për të ndarë përvojën dhe zhvillimin e strukturës mbikëqyrëse.

Gjatë seminarit u diskutuan studime rasti të bazuara në përvojën praktike të PFSA-së dhe standardet në lidhje me mbikëqyrjen e rrezeve të investimeve.

Disa nga çështjet më të rëndësishme që u diskutuan në këtë aktivitet, qenë:

- rregullimi i investimeve të siguruesve në instrumenta financiare nga prespektiva ligjore (duke u përqendruar në kufizimet ligjore të vendosura mbi siguruesit në bazë të aftësisë paguese aktuale);
- organizimi i procesit të investimit, si një element kyç për suksesin e aktivitetit të investimeve;
- modele të menaxhimit për aktivitet investuese;
- vlerësimi eficient dhe efektiv i politikës së investimeve nga perspektiva e palëve të

interesuara (duke përfshirë dhe autoritetet mbikëqyrëse);

- rrugët mbikëqyrëse ndaj rrezikut të përqendrimit (dispozitat lidhur me diversifikimin e aseteve, nivelin e duhur të fondeve të veta në dispozicion në rast të përqendrimit.

Në përfundim të seminarit, pjesëmarrësit diskutuan rreth çështjeve të ndryshme të procesit mbikëqyrës dhe sfidat praktike që shfaqeshin te ç'do autoritet mbikëqyrës të përfaqësuar.

### **IOSCO propozon parimet e mbikëqyrjes rregullatore për likuiditetin e padukshëm**

*(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) tetor 2010)*

Komiteti Teknik i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) ka publikuar një raport konsultativ me titull “Çështjet e ngritura nga likuiditeti i padukshëm” (Issues Raised by Dark Liquidity), ku jepen parimet për të asistuar autoritetet e tregjeve të letrave me vlerë të trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me likuiditetin e padukshëm. Këto parime janë zhvilluar:

- për ta minimizuar efektin negativ të padëshirueshëm që ka rritja e përdorimit grupeve të padukshme dhe porosive të padukshme në tregjet transparente te procesi i zbulimit të çmimit;
- për ta zbutur efektin e çdo copëzimi të mundshëm të informacionit dhe likuiditetit;
- për të siguruar që entet rregullatore të kenë të drejtë shikimi të informacionit të mjaftueshëm, në mënyrë që të monitorojnë përdorimin e grupeve të padukshme të fondeve dhe porosive të padukshme;
- për të siguruar që investitorët të kenë informacion të mjaftueshëm në mënyrë që të jenë në gjendje ta kuptojnë mënyrën me të cilën do të menaxhohen dhe ekzekutohen porosinë; dhe
- për të rritur monitorimin e porosive dhe

grupimeve të padukshme, në mënyrë që të mundësohet një reagim rregullator i duhur.

Komiteti Teknik po i zhvillon këto parime duke mbajtur parasysh pasojat e mundshme negative në treg dhe një sërë çështjesh të tjera që kanë të bëjnë me përdorimin e grupimeve të padukshme dhe porosive të padukshme në tregjet transparente, ku përfshihen:

- efekti te procesi i zbulimit të çmimit kur ka një numër të konsiderueshëm porosish të padukshme dhe/ose porosish të bëra në grupime të padukshme, të cilat mund të publikohen por mund edhe të mos publikohen;
- efekti që ka copëzimi i mundshëm te informacioni dhe likuiditeti; dhe
- efekti te integriteti i tregut për shkak të dallimeve të ndryshme sa i takon hyrjes në treg dhe shikimit të informacionit.

### **Transparenca për pjesëmarrësit e tregut dhe emetuesit**

**Parimi 1:** Çmimi dhe vëllimi i kërkesave dhe ofertave duhet në përgjithësi të jetë transparent për publikun. Mirëpo, kur rregullatorët mendojnë të lejojnë struktura të ndryshme tregu apo lloje porosish të cilat nuk ofrojnë transparencë përpara tregtimit, ata duhet të mbajnë në konsideratë efektin që ka kjo te zbulimi i çmimit, copëzimi, drejtësia dhe cilësia e përgjithshme e tregut.

**Parimi 2:** Informacioni lidhur me tregtimet, duke përfshirë edhe ato që ekzekutohen në grupime të padukshme ose si rezultat i porosive të padukshme të bëra në tregje transparente duhet të jetë transparent për publikun. Në lidhje me informacionin specifik që duhet bërë transparent, rregullatorët duhet të marrin në konsideratë si efektin pozitiv ashtu edhe atë negativ që ka identifikimi i një vendtregtimi të padukshëm dhe/ose fakti se tregtimi është bërë në bazë të një urdhri të padukshëm.

### Prioriteti i porosive transparente

**Parimi 3:** Në ato juridiksione ku në përgjithësi lejohet tregtimi i padukshëm, rregullatorët duhet të bëjnë hapa për të mbështetur përdorimin e porosive transparente në vend të ekzekutimit të porosive të padukshme në tregje transparente apo të porosive të bëra në grupime të padukshme. Porositë transparente duhet të kenë prioritet në krahasim me porositë e padukshme me të njëjtin çmim brenda një vendtregtimi.

### Raportimi përpara rregullatorëve

**Parimi 4:** Rregullatorët duhet të kenë një regjim raportimi dhe/ose mjete informimi lidhur me porositë dhe informacionin e tregtimeve në vendtregtime ku ofrohet tregtim i grupimeve të padukshme apo porosive të padukshme.

### Informacioni që u vihet në dispozicion pjesëmarrësve të tregut lidhur me grupimet e padukshme dhe porositë e padukshme

**Parimi 5:** Grupimet e padukshme dhe tregjet transparente që ofrojnë porosi të padukshme duhet t'u japin pjesëmarrësve të tregut informacion të mjaftueshëm në mënyrë që të jenë në gjendje ta kuptojnë mënyrën me të cilën përpunohen dhe ekzekutohen porositë e tyre.

### Rregullimi i zhvillimit të grupimeve të padukshme dhe porosive të padukshme

**Parimi 6:** Rregullatorët duhet të monitorojnë periodikisht zhvillimin e grupimeve të padukshme dhe të porosive të padukshme në territoret e tyre për t'u siguruar që këto zhvillime të mos kenë pasoja negative për eficientësinë e procesit të formimit të çmimeve në tregjet e dukshme dhe të marrin masat e duhura sipas nevojës.

### Edukimi i konsumatorit

### Administrimi dhe mbikëqyrja e risqeve në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) tetor 2010)

Vijon nga numri i kaluar...

### III. Çfarë mekanizmash mund të përdoren për t'i mbajtur nën kontroll risqet në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara?

17. Në këtë material risqet kryesore të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara (duke pasur parasysh se ndikojnë drejtpërdrejt në kursimet e akumuluar për pensione dhe për rrjedhojë ndikojnë te shumica e pensionit) kategorizohen si më poshtë:<sup>1</sup>

- risku i investimit;
- kostot e larta;
- risqet e shfrytëzimit (duke përfshirë edhe administrimin e llogarive individuale dhe kalimin e funksioneve të tretët);
- menaxhimi i kalimit nga akumulimi të dekulimit.

18. Risku i sigurimit të fondeve, shqetësimi kryesor për pensionet me përfitime të përcaktuara mund të përbëjë shqetësim serioz në disa sisteme me kontribute të përcaktuara të cilat ofrojnë dorëzani, por kjo nuk trajtohet me hollësi në këtë material.

#### 1. Mekanizmat e transparencës dhe edukimit

20. Mënyra e parë për të provuar menaxhimin e risqeve brenda sistemeve të pensioneve me kontribute të përcaktuara është rritja e njohurive të anëtarëve. Nëse çështja kryesore që lidhet me problemet e sistemeve me kontribute të përcaktuara është se individëve u mungojnë dijet dhe angazhimi për menaxhimin e risqeve ndaj të cilave janë zbuluar, atëherë mënyra e parë për të bërë përpjekje për t'i zbutur këto risqe është duke u dhënë atyre informacionin dhe asistencën e nevojshme për t'i administruar vetë këto risqe. Kjo mund të bëhet me disa mënyra, të cilat

<sup>1</sup> Edhe shumica e kontributeve që jepen në skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara është e rëndësishme, por kjo nuk diskutohet me hollësi në këtë material (shih (OECD 2010 – pritet të publikohet)).

paraqiten më poshtë:

#### *Dhënia e informacionit*

21. Një mënyrë se si mund të bëhet kjo është përmes vendosjes së kërkesave ligjore për dhënien e informacioneve shpjeguese, për fondet e pensioneve, pas së cilës mbikëqyrësit e pensioneve mund të kontrollojnë, nëse janë dhënë apo jo si duhet këto informacione.

22. Udhëzimet e OECD-së me titull “Guidelines for the Protection of Rights of Members and Beneficiaries in Occupational Pension Plans” (Udhëzues për mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve dhe përfituesve të planeve të pensioneve profesionale) (OECD 2003) japin kërkesa të hollësishme për dhënien e informacioneve shpjeguese. Këto udhëzime theksojnë se anëtarëve dhe përfituesve të skemave me kontribute të përcaktuara, të cilëve u kërkohet t'i monitorojnë vetë investimet e tyre, duhet t'u jepet informacioni i mëposhtëm:

- a. informacion i mjaftueshëm mbi të cilin t'i mbështesë vendimet çdo anëtar i skemës;
- b. natyra e instrumenteve financiare që mund të përdorë (duke përfshirë edhe riskun e ecurisë së investimit);
- c. informacion të standardizuar, të përputhshëm dhe të plotë lidhur me zgjedhjet e investimeve (duke përfshirë pagesat, tarifën e shpenzimeve, përbërjen e portofolit, të dhënat për ecurinë e investimit).

23. E rëndësishme është jo vetëm se çfarë informacioni u jepet anëtarëve dhe përfituesve, por edhe si u jepet ky informacion. Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS) rekomandon (IAIS 2006) se informacioni duhet të jetë:

- a. aktual për vendimet që merr pjesëmarrësi i tregut;
- b. në kohë, për të qenë në dispozicion dhe i përditësuar në momentin e marrjes së

vendimeve;

- c. i arritshëm për pjesëmarrësit e tregut pa shpenzime ose vonesa të panevojshme;
- d. i plotë dhe i kuptimtë për t'u dhënë mundësi pjesëmarrësve të krijojnë një pamje të plotë të siguruesit;
- e. i besueshëm si bazë mbi të cilën të merren vendimet;
- ë. i krahasueshëm midis ofruesve të ndryshëm;
- f. konsekuent me kalimin e kohës për të mundësuar dallimin e trendit.

24. Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve e pranojnë bashkërisht se kanë një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e dhënies së këtij informacioni, sidomos për të kontrolluar saktësinë e tij. Autoritetet duhet të mendojnë se si ta vendosin theksin në elementet e ndryshëm të dhënies së informacionit dhe si ta mbikëqyrin dhënien e informacionit në mënyrë që të arrihen synimet e mbikëqyrjes. Shpesh, zbatohen norma më të forta për dhënien e informacioneve shpjeguese dhe këshillave në nivel shitjeje me pakicë, në krahasim me informacionin e dhënë midis institucioneve të shërbimeve financiare dhe autoritetet rregullatore, të cilët mund të luajnë një rol për vënien në zbatim të këtyre normave.<sup>2</sup>

25. Autoritetet mbikëqyrëse mund të kontrollojnë si e japin informacionin skemat e pensioneve, duke parashikuar edhe kërkesa ligjore (ndonjëherë të rrepta) për përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së informacionit. Kjo mund të bëhet me shumë mënyra:<sup>3</sup>

- Në disa vende si: (Kili, Italia, Meksika dhe Sllovakia) autoritete mbikëqyrëse përcaktojnë formatin e dokumenteve.
- Shpesh autoritetet mbikëqyrëse përcaktojnë si duhen raportuar fondet, për shembull

<sup>2</sup> Me rëndësi të veçantë në BE janë propozimet e Komisionit Evropian për një regjim rregullator të harmonizuar për produktet e investimeve që shiten në paketë me pakicë (PRIPs).

<sup>3</sup> Material pune i IOPS-it, nr. 5, “Information to Members of DC Pension Plans: Conceptual Framework and International Trends (Informacioni për anëtarët e skemave të pensionit me kontribute të përcaktuara: kuadri konceptual dhe prijet ndërkombëtare) (IOPS 2008) ku jepen shembuj të tjerë të mënyrës si mund të jepet në praktikë ky informacion.

raportimi i kthimeve pas zbritjes së pagesave, shpeshësia e raportimit dhe përdorimi i një formati të lehtë për përdoruesit. Për shembull, enti mbikëqyrës nigerian kërkon raportim publik periodik të normave të kthimit, të llogaritura sipas një formule të përcaktuar të mbështetur në shifra të audituara dhe të vendosur pranë shifrave krahasuese nga skemat me ecuri më të mirë dhe më të keqe nga skemat e tjera (10).<sup>4</sup> Në Itali, nga të gjitha skemat pritet një formë e standardizuar e dhënies së informacioneve shpjeguese pavarësisht nëse këto skema janë të organizuara nga punëdhënës apo sigurues.

- Disa autoritete mbikëqyrëse kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese për të mbuluar riskun si edhe kthimin. Për shembull, autoriteti i Hong Kongut kërkon dhënien e informacionit (të paktën, çdo gjashtë muaj) të një matjeje të standardizuara të riskut<sup>5</sup> si edhe për ecurinë e standardizuar.
- Në mënyrë të ngjashme, autoritetet mbikëqyrëse mund të kërkojnë dhënien e informacionit për matjet e luhatshmërisë (për shembull, Bullgari, Izrael, Itali dhe Turqi) ose siç është rasti i Meksikës dhe Izraelit, të cilët kërkojnë dhënien e informacionit për vlerën e matjes së riskut.
- Autoriteti mbikëqyrës mundet të kujdeset, siç është rasti i Izraelit, që çdo drejtor risku i skemës të raportojë çdo vit për risqet që u kanosen anëtarëve dhe skemës.
- Në disa vende, si Bullgaria, Hong Kongu dhe Sllovakia, autoriteti mbikëqyrës aprovon dokumentet kyçe përpara publikimit.
- Disa autoritete mbikëqyrëse kontrollojnë zbatimin e kërkesës ligjore për dhënien e informacioneve shpjeguese, anëtarëve dhe përfituesve të skemave. Në Turqi kjo kërkon një kontroll të hollësishëm të informacioneve shpjeguese, ndërsa autoriteti mbikëqyrës irlandez i kërkon një kampioni skemash të dorëzojnë informacionin që u japin anëtarëve,

për ta kontrolluar lidhur me kërkesat legjislative.

26. Transparenca dhe krahasimi i kostove është gjithashtu një fokus i veçantë i shumë autoriteteve mbikëqyrëse dhe madje në shumë prej shembujve që jepen lart kërkohet edhe dhënia e informacionit shpjegues për kostot në një formati të standardizuar, ose më vete ose duke kërkuar dhënien e informacioneve për kthimet neto (më shumë hollësi do të jepen në pjesën për kostot).

27. Krahas kësaj, autoritetet mbikëqyrëse mund të veprojnë vetë si burime informacioni, duke dhënë informacione të standardizuara krahasuese për ofrues të veçantë dhe për tregun në tërësi (si është rasti i Kilit dhe Hong Kongut). Kjo mund të evitohet problemet që mund të lindin kur secila skemë pensioni thekson informacionin që e vendos në dritën më të mirë (për shembull përmes zgjedhjeve të matura të masave që mund t'i duken më të mira secilës skemë: një informacion që mund të jetë më i miri këtë muaj, një tjetër që mund të jetë më i miri këtë vit dhe një tjetër për tre muajt e fundit, etj.). Mirëpo, autoritetet mbikëqyrëse duhet ta dinë se përcaktimi i informacionit krahasues që duhet dhënë mund të ndikojë në natyrën e konkurrencës midis ofruesve, duke qenë konkurrenca mund të orientohet nga kriteret e vendosura. Në raste të tilla, nëse autoritetet mbikëqyrëse zgjedhin matje ecurie të papërshtatshme (sidomos nëse këto janë tejet afatshkurtra) personave nuk u mbetet tjetër veç t'i zgjedhin ofruesit e pensioneve në bazë të kriterëve të papërshtatshme, për shembull në bazë të treguesve të ecurisë afatshkurtër.

28. Në mënyrë alternative, autoritetet mbikëqyrëse mund të marrin një rol për të ndihmuar që individët ta kuptojnë informacionin që u jepet. Për shembull, sjellja holandeze e rregullatorit të biznesit<sup>6</sup> ndjek një qasje që ka të ngjarë të jetë e vetme lidhur me vënien në zbatim të legjislacionit i cili u kërkon ofruesve të

<sup>4</sup> Nga ana e saj, kjo do të thotë se të gjitha skemat duhet ta mbyllin vitin më të njëjtën datë.

<sup>5</sup> Llogaritje trevjeçare e devijimit standard.

<sup>6</sup> Autoriteti i Tregjeve Financiare i Vendeve të Ulta – AFM.

pensioneve me kontribute të përcaktuara të dëshmojnë se janë kujdesur në maksimum që zgjedhjet e çdo anëtari (kur nuk është përzgjedhur fondi i zgjedhjes së parë) të jetë e informuar nga rrethanat personale dhe financiare dhe nga dëshira për të marrë risk. Ofruesi holandez (zakonisht sigurues) duhet ta këshillojë punëmarrësin, duke marrë në konsideratë synimin e vet financiar, gjendjen financiare, dëshirën për risk, njohurinë për investimet dhe përvojën me investimet.<sup>7</sup>

29. Gjatë krizës financiare dhe ekonomike të vitit 2008 dhe 2009, shumë autoritete mbikëqyrëse të pensioneve e rritën rolin e tyre komunikues (shih IOPS, 2009b). Fushatat e ndërgjegjësimit theksuan natyrën afatgjatë të kursimeve për pensione dhe rreziqet që lindin kur i përgjigjesh luhatshmërisë afatshkurtër përmes ndërrimit të fondeve (për të kaluar te fonde konservative) ose përmes daljes nga skema (duke përfshirë edhe pagesat e mundshme).

30. Më në përgjithësi, autoritetet mbikëqyrëse mund të kërkojnë rritjen e nivelit të përgjithshëm të edukimit financiar të komunitetit, shpesh në partneritet me agjencitë e tjera, në bazë të supozimit se dije më të mira duhet të sjellin vendime më të informuara të anëtarëve të skemave të pensioneve (shih OECD 2008).<sup>8</sup> Përpjekje të tilla mund të gërshetohen me dëshirën për të rritur pjesëmarrjen në kursimet për pensione, aty ku kjo nuk është e detyrueshme. Për shembull:

- Autoriteti mbikëqyrës i Hong Kongut publikon informacion të shkruar qartë për anëtarët në hapësirën e vet në internet për t'i ndihmuar t'i kuptojnë nevojat e tyre për pension, për të bërë zgjedhjen e skemës dhe për të marrë dhe kuptuar informacione të tjera të lidhura drejtpërdrejt me investimin në fondin e detyrueshëm të pensionit.

- Autoriteti mbikëqyrës kilian ka marrë buxhet të veçantë për veprimtaritë e edukimit financiar. Ky autoritet u ka vënë tashmë emra të tjerë fondeve në modelin e tij me shumë fonde, për ta bërë më të qartë nëse janë fonde me rritje, fonde të drejtpeshuar ose fonde konservative, në kuadër të përpjekjes për t'i ndihmuar anëtarët t'i kuptojnë mundësitë që kanë përpara.

- Autoriteti irlandez i mbikëqyrjes (Këshilli i Pensioneve) ka ndërmarrë turne dhe fushata reklamash për ta ndihmuar publikun t'i kuptojë zgjedhjet që kanë për pensionet dhe për t'i rritur kursimet për pension.<sup>9</sup>

31. Duhet theksuar se përdorimi i transparencës dhe edukimit, për ta zbutur problemin e mungesës së informacionit nga ana e anëtarëve të skemave me kontribute të përcaktuara, nuk është një zgjidhje e shpejtë por duhet trajtuar si një politikë afatgjatë nga ana e autoriteteve mbikëqyrëse.

*Vijon në numrin tjetër...*

<sup>7</sup> Idealja do të ishte që ofrues t'i organizonte investimet sipas ciklit të jetës, në mënyrë që punëmarrësi të ketë gjasa të marrë vlerën e preferuar të të ardhurave. Me fjalë të tjera, ofruesi duhet ta mbështesë këshillën e vet të vlera e të ardhurave që dëshiron të ketë punëmarrësi apo të shkalla me të cilën është i gatshëm ta pranojë probabilitetin e arritjes së të ardhurave të preferuara për të qenë në gjendje të marrë më shumë risqe për një kthim edhe më të lartë. Marrëdhënia midis ofruesit dhe punëmarrësit duhet të mos fokusohet te investimet apo shpërndarja e primeve nëpër klasat e aktiveve por te një nivel i preferuar i të ardhurave nga pensionet dhe siguria e preferuar e arritjes së të ardhurave. Vetëm nëse ofruesi i ka bërë të gjitha këto mund ta shmangë përgjegjësinë e besnikërisë për ecurinë negative të fondeve jo të falimentuara.

<sup>8</sup> Më shumë informacion për punën për edukimin financiar që bën OECD mund të gjeni në [www.financial-education.org](http://www.financial-education.org)

<sup>9</sup> Informacionin për fushatën irlandeze mund ta gjeni në <http://www.pensionsboard.ie/index.asp?locID=134&docID=-1>. Për informacion lidhur me fushatat kombëtare të ndërgjegjësimit dhe edukimit në vende të tjera, shih (IOPS 2008f).

### ***Për këtë numër punuan:***

E. Shehi, R. Guri, V. Theodhori, F. Musta, F. Hevovija, P. Berberi, E. Beqir-Aga, E. Sherri, R. Eltari, E. Kokona

